

VENDIM
Nr. 422, datë 6.5.2020

**PËR PËRBËRJEN, RREGULLAT E FUNKSIONIMIT DHE TRAJTIMIN FINANCIAR
TË GRUPIT NEGOCIATOR DHE DETYRAT E KRYENEGOCIATORIT PËR
ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE TË ADERIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
NË BASHKIMIN EVROPIAN**

(Ndryshuar me VKM nr. 994, datë 9.12.2020; nr. 746, datë 9.12.2021; nr. 520, datë 29.7.2022)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe në vijim të vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PËRBËRJA E GRUPIT NEGOCIATOR

1. Grupi Negociator, përgjegjës për zhvillimin e procesit teknik të negociatave të aderimit me institucionet e Bashkimit Evropian, i ngritur me vendimin nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, në kryerjen e detyrave të parashikuara në pikën 3, të kreut V, të vendimit të sipërpërmendur, përbëhet nga:

- Znj. Majlinda Dhuka, ministër Shteti dhe Kryenegociator (në vijim “Kryenegociatori”);
- Znj. Adea Pirdeni, zëvendësministër i Drejtësisë, negociator përgjegjës për kriteret politike dhe kapitullin 23 të legjislacionit të Bashkimit Evropian;
- Z. Besfort Lamallari, zëvendësministër i Brendshëm dhe z. Julian Hodaj, zëvendësministër i Brendshëm, bashkënegociatorë përgjegjës për kapitullin 24;
- Znj. Megi Fino, zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, negociator përgjegjës për kapitullin 31;
- Znj. Adela Xhemali, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, negociator përgjegjës për kriteret ekonomike dhe kapitujt 4, 32 dhe 33;
- Z. Besart Kadia, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, negociator përgjegjës për kapitujt 1, 2, 3, 6, 7, 20 dhe 30, si dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitujt 19, 28;
- Shfaqizuar;
- Znj. Vasilika Vjero, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, negociator përgjegjës për kapitujt 16 dhe 29;
- Z. Ilir Bejtja, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, negociator përgjegjës për kapitullin 15;
- Znj. Ermira Gjeçi, zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, negociator për kapitujt 11 dhe 12;
- Z. Roland Kristo, zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, negociator për kapitullin 13;
- Znj. Albana Tole, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit, negociator përgjegjës për kapitullin 25;
- Znj. Nina Guga, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit, negociator për kapitullin 26;

- Znj. Ornela Çuçi, zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit, negociator për kapitullin 27;
- Znj. Natasha Ahmetaj, zëvendësguvernator i dytë në Bankën e Shqipërisë, negociator përgjegjës për kapitullin 17;
- Znj. Reida Kashta, drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Prokurimit Publik, negociator për kapitullin 5;
- Z. Denar Biba, kryetar i Autoritetit të Konkurrencës, negociator për kapitullin 8¹;
- Z. Ervin Mete, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, negociator për kapitullin 9;
- Znj. Elsa Dhuli, INSTAT, negociatore për kapitullin 18.
- Znj. Romina Kuko, zëvendësministër i Brendshëm, negociator përgjegjës për kapitullin 22;
- Znj. Enkelejda Muçaj, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, negociator përgjegjës për kapitujt 14 dhe 21, dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 10;
- Znj. Denada Seferi, zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bashkënegociator përgjegjës për kapitujt 19 dhe 28;
- Znj. Mirlinda Karçanaj, drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 10;
- Znj. Albana Koçi, drejtor i Departamentit të Administratës Publike, negociator përgjegjës për reformën në administratën publike.

2. Grupi Negociator mbështet punën e Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian dhe Delegacionit Shtetëror sipas parashikimeve të vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave.

3. Anëtarët e Grupit Negociator veprojnë për të përmbushur përgjegjësitë që lidhen me procesin teknik të negociatave të aderimit në Bashkimin Evropian, me të cilat i ngarkon vendimi nr.749, datë 19.12.2018, i Këshillit të Ministrave.

4. Çdo anëtar i Grupit Negociator paraqet të paktën çdo tre muaj te Kryenegociatori apo me kërkesë të tij në një afat tjetër një raport mbi ecurinë e negociatave në kapitujt, për të cilët është përgjegjës, me të gjitha informacionet e nevojshme mbi veprimtaritë e anëtarit përgjegjës dhe mbi aktivitetet që lidhen me kapitullin.

5. Pas çdo takimi të Konferencës Ndërqeveritare midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, Grupi Negociator përgatit një raport mbi ecurinë e negociatave i cili i paraqitet nga Kryenegociatori Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian dhe Këshillit të Ministrave. Me kërkesë të Këshillit të Ministrave, anëtarët e ekipit negociator përgatisin dhe paraqesin raporte të veçanta, sipas kërkesës. Hartimi i raporteve të tilla bashkërendohet dhe paraqitet në Këshillin e Ministrave nga Kryenegociatori.

6. Anëtarët e Grupit Negociator bashkëkryesojnë nënkomitetet e stabilizimit dhe asociimit, Bashkimi Evropian – Shqipëri, si më poshtë vijon:

a) Nënkomiteti i Stabilizimit dhe Asociimit, Bashkimi Evropian-Shqipëri, “Drejtësia, liria dhe siguria” bashkëkryesohet nga negociatori përgjegjës për kapitullin 23;

b) Nënkomiteti i Stabilizimit dhe Asociimit Bashkimi Evropian-Shqipëri, “Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca”, bashkëkryesohet nga negociatori përgjegjës për kapitujt 1, 2, 3, 6, 7, 20 dhe 30, si dhe bashkënegociatori përgjegjës për kapitujt 19 dhe 28;

c) Nënkomiteti i Stabilizimit dhe Asociimit Bashkimi Evropian-Shqipëri “Transporti, mjedisi, energjia dhe zhvillimi rajonal”, bashkëkryesohet nga negociatori përgjegjës për kapitujt 14 dhe 21, dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 10;

ç) Nënkomiteti i Stabilizimit dhe Asociimit Bashkimi Evropian-Shqipëri, “Tregtia, industria, doganat dhe tatimet” bashkëkryesohet nga negociatori përgjegjës për kapitujt 16 dhe 29;

¹ ndryshuar me korrigjim gabimi material botuar në fletoren zyrtare nr. 105, datë 5.6.2020

d) Nënkomiteti i Stabilizimit dhe Asociimit Bashkimi Evropian–Shqipëri ‘Për inovacionin, shoqërinë e informacionit dhe politikat sociale’ bashkëkryesohet nga negociatori përgjegjës për kapitujt 14 dhe 21 dhe bashkënegociatori përgjegjës për kapitullin 10;

dh) Nënkomiteti i Stabilizimit dhe Asociimit Bashkimi Evropian–Shqipëri, “Çështjet ekonomike, financiare dhe statistikat”, bashkëkryesohet nga negociatori përgjegjës për kriteret ekonomike, dhe kapitujt 4, 32 dhe 33;

e) Nënkomiteti i Stabilizimit dhe Asociimit, Bashkimi Evropian-Shqipëri, “Bujqësia dhe peshkimi” bashkëkryesohet nga negociatori përgjegjës për kapitujt 11 dhe 12.

7. Anëtarët e Grupit Negociator, në bashkërendim me Kryenegociatorin, me qëllim garantimin e prioritetëve të kapitujve specifike gjatë hartimit të programimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për sektorët, për të cilët janë përgjegjës, japin mendim gjatë procesit të identifikimit të prioritetëve për mbështetje. Kryenegociatori i paraqet Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës prioritetet e dakordësuara në Grupin Negociator. Institucioni përgjegjës për kryesimin e secilit kapitull negociues siguron zbatimin e parashikimeve të kësaj pike.

7/1. Kryenegociatori, në koordinim me Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës jep mendim gjatë prioritizimit të projekteve me rëndësi kombëtare, në përputhje me prioritetet e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, strategjitë kombëtare ndërsektoriale dhe sektoriale.

7/2. Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës informon Kryenegociatorin për procesin e identifikimit të prioritetëve dhe programimit të asistencës financiare të BE-së, në funksion të procesit të aderimit në Bashkimin Evropian dhe të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

8. Shfuqizuar.

9. Grupi Negociator mbështetet në funksionet e tij nga Sekretariati i Integritimit Evropian, siç përcaktohet në kreun VII, të vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave.

II. KRYENEGOCIATORI

1. Kryenegociatori në zbatim të parashikimeve të vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, ka përgjegjësi për kryerjen e negociatave teknike të anëtarësimit në BE për të gjithë kapitujt negociues. Në veçanti, Kryenegociatori ka këto detyra:

- a) Drejton punën e Grupit Negociator;*
- b) Udhëzon Sekretariatit e Integritimit Evropian në zbatimin e detyrave përkatëse;*
- c) Siguron unitetin e veprimit të Grupit Negociator duke bashkërenduar punën e tij;*
- ç) Përfaqëson Grupin Negociator duke nënshkruar dhe duke përcjellë aktet e vendimet e tij;*
- d) Thërret takimet apo mbledhjet e Grupit Negociator dhe drejton diskutimin e anëtarëve të tij sipas agjendës së hartuar paraprakisht;*

dh) Vendors për mundësinë e hapjes për publikun të mbledhjeve të Grupit Negociator;

e) Emëron një anëtar të Grupit Negociator si drejtues të një çështjeje specifike të negociatave, nëse kjo çështje trajtohet në më shumë se një kapitull të acquis të BE-së ose nëse më shumë se një anëtar i Grupit Negociator merret me të njëjtën temë;

ë) Përcjell vendimet e Grupit Negociator, që kanë të bëjnë me një kapitull të veçantë të acquis të BE-së, te kryesuesi dhe anëtarët e grupit përgjegjës ndërinstitucional të punës, së bashku me procesverbalin e mbledhjes së Grupit Negociator;

f) I propozon Grupit Negociator metodologjinë dhe afatet për përgatitjen e qëndrimit negociues për çdo kapitull nga grupi ndërinstitucional i punës, përgjegjës për kapitullin, pas një vlerësimi të plotë dhe analizës së raportit të shqyrtimit (screening) të Komisionit Evropian;

g) Paraqet pranë Bashkimit Evropian, përmes Misionit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, qëndrimin negociues për çdo kapitull dhe çdo dokument tjetër mbështetës, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, në vijim të marrjes së opinionit nga Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian dhe shqyrtimit nga Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian;

gj) Informon institucionet e Bashkimit Evropian dhe vendet anëtare të BE-së lidhur me pikëpamjet e Shqipërisë për çështjet që lidhen me negociatat e anëtarësimit, përmes Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe misionëve diplomatike të Republikës së Shqipërisë;

h) Përcjell, përmes Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, udhëzimet e Grupit Negociator për misionet diplomatike të Republikës së Shqipërisë;

i) I përcjell Grupit Negociator të gjitha informacionet përkatëse nga institucionet e Bashkimit Evropian, shtetet anëtare të BE-së dhe vendet e tjera kandidate të BE-së;

j) Përcjell pranë shteteve të BE-së, institucioneve të BE-së dhe vendeve të tjera kandidate, përmes Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, kërkesat e Grupit Negociator për informacion dhe mendime lidhur me hartimin e qëndrimeve negociuese dhe çdo kërkesë tjetër të Grupit Negociator për informacion të nevojshëm në lidhje me një kapitull të veçantë apo me procesin e negociatave;

k) Miraton kërkesat e Grupit Negociator në lidhje me angazhimin profesional të organizatave profesionale apo çdo subjekti të ndryshëm nga anëtarët e Grupit Negociator dhe kryen angazhimin e ekspertëve të fushave të ndryshme për të mbështetur kryerjen e detyrave të tij apo të detyrave dhe nevojave të grupit negociator për çështje të veçanta komplekse, pasi të ketë marrë miratimin e kryetarit të Delegacionit Shtetëror apo të personit të autorizuar prej tij. Nëse një veprim i tillë kërkon alokim fondesh shtesë, Kryenegociatori, pas marrjes së mendimit të ministrisë përgjegjëse për financat, paraqet kërkesën pranë Këshillit të Ministrave;

l) I paraqet, të paktën çdo tre muaj, Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian dhe Këshillit të Ministrave një raport të konsoliduar mbi përparimin e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, bazuar në raportet tremujore të anëtarëve të Grupit Negociator sipas pikës 3, të kreut I, të këtij vendimi;

ll) Bashkëkryeson Komitetin e Stabilizimit dhe Asociimit BE-Shqipëri dhe është pjesë e delegacionit shqiptar në Këshillin e Stabilizimit dhe Asociimit BE-Shqipëri;

m) Merr pjesë në cilësinë e zëvendëskryetarit në Delegacionin Shtetëror dhe në cilësinë e anëtarit në Komitetin Shtetëror për Integrimin Evropian;

n) Harton një udhëzim kuadër të koordinimit të punës së Sekretariatit të Integritimit Evropian, i cili është pjesë përbërëse e rregullave të funksionimit të Sekretariatit, që miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për Evropën, sipas parashikimeve të vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave.

nj) Nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me qëllim rritjen e efikasitetit të punës së Grupit Negociator dhe kryerjen e detyrave përkatëse pas marrjes së miratimit nga kryetari i Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian;

o) Çdo detyrë dhe funksion të parashikuar në vendimin nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave.

2. Kryenegociatori siguron pjesëmarrjen e anëtarëve të Grupit Negociator në programimin dhe monitorimin e asistencës financiare të BE-së në kapitujt, për të cilët ata janë përgjegjës.

3. Shfuqizuar.

4. Në rastet e mungesave, të pamundësisë apo të paaftësisë fizike për të vepruar të Kryenegociatorit, detyrat e përcaktuara në këtë kre kryhen nga zëvendëskryenegociatori, i cili përcaktohet me akt të veçantë të Kryenegociatorit nga radhët e negociatorëve. Zëvendëskryenegociatori kryen dhe detyra të tjera me kërkesë të Kryenegociatorit.

III. KABINETI I KRYENEGOCIATORIT

1. Kabineti i Kryenegociatorit funksionon pranë Kryeministrisë dhe në Misionin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Struktura dhe funksionimi i tij miratohen me urdhër të Kryeministrit.

2. Kabineti në koordinim me *Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës* njësinë përgjegjëse për nismat ligjore prioritare dhe acquis në Kryeministri dhe Sekretariatit e Integritimit Evropian i siguron Kryenegociatorit ndihmën e duhur teknike dhe asistencën administrative për të mbështetur zbatimin e detyrave të tij.

3. Funksionarët e kabinetit të Kryenegociatorit emërohen me urdhër të Kryeministrit, me propozim të Kryenegociatorit.

IV. RREGULLAT E FUNKSIONIMIT TË GRUPIT NEGOCIATOR

1. Projektpropozimet për qëndrimet negociuese, të hartuara nga grupet ndërinstitucionale të punës për çdo kapitull të acquis, shqyrtohen nga anëtari i Grupit Negociator, përgjegjës për kapitullin. Anëtari i Grupit Negociator, përgjegjës për kapitullin, propozon qëndrimin e Grupit Negociator për projektpropozimet për qëndrimet negociuese para se ato t'i përcillen Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian, sipas vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave.

2. Vlerësimi analitik i harmonizimit të legjislacionit vendas me acquis, i përgatitur sipas vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, nga grupi ndërinstitucional i punës për integrimin evropian për çdo kapitull shqyrtohet nga anëtari i Grupit Negociator, përgjegjës për kapitullin.

3. Anëtari i Grupit Negociator, përgjegjës për kapitullin, propozon qëndrimin e Grupit Negociator për vlerësimin analitik para se Grupi Negociator të vendosë formën përfundimtare të vlerësimit analitik që do t'i paraqitet Komisionit Evropian.

4. Takimet e Grupit Negociator thirren nga Kryenegociatori dhe mbahen të paktën një herë në muaj. Një ftesë me shkrim u dërgohet anëtarëve të Grupit Negociator të paktën pesë ditë para takimit. Projektrendi i ditës së mbledhjes, procesverbali i mbledhjes së mëparshme dhe materialet e tjera të rëndësishme do t'u dorëzohen anëtarëve të Grupit Negociator së bashku me ftesën me shkrim.

5. Pjesëmarrja në takime është e detyrueshme. Në rast të pamundësisë për të marrë pjesë, anëtari i Grupit Negociator informon Kryenegociatorin përpara datës së takimit dhe cakton një përfaqësues zëvendësues për të marrë pjesë në takim.

6. Takimet e Grupit Negociator kryesohen nga Kryenegociatori dhe konsiderohen të vlefshme vetëm kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Në fillim të çdo mbledhjeje miratohet procesverbali i mbledhjes së mëparshme. Anëtarët e Grupit Negociator kanë të drejtë të bëjnë komente me shkrim para mbledhjes ose gojarisht gjatë takimit. Pas miratimit të procesverbalit të mbledhjes së mëparshme dhe me propozimin e Kryenegociatorit, miratohet rendi i ditës i mbledhjes. Në raste të justifikuara dhe urgjente, me propozimin e Kryenegociatorit ose të një anëtari të Grupit Negociator, rendi i ditës së mbledhjes mund të ndryshohet dhe të plotësohet me materiale ose dokumente që nuk ishin përfshirë fillimisht. Ndryshimet në rendin e ditës kërkojnë miratimin e shumicës së anëtarëve të pranishëm të Grupit Negociator.

7. Nëse është e nevojshme, me ftesë të Kryenegociatorit, në mbledhjet e Grupit Negociator mund të marrin pjesë edhe ekspertë që nuk janë anëtarë të Grupit Negociator. Ekspertët marrin pjesë në diskutim pa të drejtë vote.

8. Informacioni dhe dokumentacioni i përgatitur nga Grupi Negociator mund të jenë të disponueshme për publikun, me vendim të Kryenegociatorit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Udhëzimet në lidhje me deklaratat publike ose paraqitjen publike të një anëtari të Grupit Negociator jepen nga Kryenegociatori.

9. Kryenegociatori dhe anëtarët e Grupit Negociator kanë të drejtën e aksesit në informacionin e klasifikuar në lidhje me fushën e përgjegjësisë së tyre, në përputhje me legjislacionin përkatës.

10. Qëndrimet e Grupit Negociator miratohen me votim. Votimi është i hapur. Një vendim konsiderohet i miratuar nëse merr shumicën e votave nga anëtarët e pranishëm të Grupit Negociator.

11. Procesverbali i takimit të Grupit Negociator përgatitet nga Sekretariati i Integrimit Evropian. Drafti i procesverbalit të mbledhjes u komunikohet në mënyrë elektronike anëtarëve të Grupit Negociator jo më vonë se një javë pas mbledhjes. Takimet e Grupit Negociator mund të regjistrohen. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga Kryenegociatori.

12. Në mbledhjen e parë të Grupit Negociator miratohet rregullorja e brendshme e funksionimit.

V. TRAJTIMI FINANCIAR

1. Kryenegociatori dhe anëtarët e Grupit Negociator, përveç pagës së tyre mujore, përfitojnë dhe shpërblim për rezultatet, sipas përcaktimeve të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

2. Subjektet joanëtare të Grupit Negociator mund të përfitojnë, sipas angazhimit të tyre dhe detyrave specifike të akorduara nga Kryenegociatori, një pagesë në përputhje me përcaktimet e vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

3. Shpenzimet e udhëtimit të anëtarëve të Grupit Negociator do të mbulohen nga autoritetet shtetërore dhe organet e administratës shtetërore në të cilat janë punësuar anëtarët e Grupit Negociator, në përputhje me legjislacionin që rregullon mbulimin e shpenzimeve të udhëtimeve dhe për dietat për punonjësit e ministrive e të institucioneve buxhetore, kur dalin jashtë shtetit.

4. Shpenzimet e udhëtimit të anëtarëve të Grupit Negociator, të cilët nuk janë të punësuar nga autoritetet shtetërore dhe organet e administratës shtetërore, do të përballohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për Evropën, në përputhje me legjislacionin që rregullon mbulimin e shpenzimeve të udhëtimeve dhe për dietat për punonjësit e ministrive e të institucioneve buxhetore, kur dalin jashtë shtetit.

5. Shfuqizuar.

6. Udhëtimet për shërbim jashtë shtetit për anëtarët e Grupit Negociator propozohen për miratim nga Kryenegociatori tek autoriteti shtetëror që mbulon shpenzimet përkatëse.

7. Anëtarët e Grupit Negociator i paraqesin raport me shkrim Kryetarit të Delegacionit Shtetëror, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, brenda 7 (shtatë) ditëve nga përfundimi i udhëtimit të punës.

VI. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Kryenegociatori dhe kabineti i tij ndihmës të shtohen si njësi organizative e veçantë në strukturën e Kryeministrit.

2. Rregullimet lidhur me burimet njerëzore dhe ato financiare për Grupin Negociator do të bëhen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Departamenti i Administratës Publike, anëtarët e Grupit Negociator dhe institucionet e përmendura në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama